



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 11 paragrafi 4 të Rregullores nr. 03/2023 për procedurat për hetimet administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 05.03.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti APK-DPKI-2044/24, për zyrtarin e lartë publik z. Arbër Sadiki, ish - Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, tani Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mjedisit në këtë komunë, për shkak se nuk ka prova që e argumentojnë dyshimin për ekzistimin e konfliktit të interesit sipas LPKI-së.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë publik z. Arbër Sadiki, ish - Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, tani Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mjedisit në këtë komunë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast (DPKI-2044/24) ka filluar të trajtohet pas informatës/kërkesës së pranuar nga jashtë (raportuesi i rastit), me të cilën është ngritur dyshimi për konflikt të interesit për z. Arbër Sadiki, pasi që siç pretendohet, citojmë nga raportimi: "[...] Në vitin 2019, Arkitekti Arbër Sadiki në kuadër të kompanisë së tij kishte punuar në hartimin e dokumentacionit për qendrën tregtare në zonën industriale Prishtinë - Fushë Kosovë. Në vitin 2023, pronarët e kësaj qendre kanë shtruar kërkesë për ndryshim plotësimin e kushteve ndërtimore me punimin e një kompanie të një arkitekti tjetër, por lënda është aprovuar nga Drejtoria e Urbanizmit e cila është udhëheq nga Arbër Sadiki deri korrik 2024. "

Lidhur me pretendimin si më lartë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) i është referuar edhe shkrimit të publikuar në portal online¹.

¹ <https://kallxo.com/gjate/oborri-i-devollit/>

Konkretisht në shkrimin e referuar, ndër të tjera, është theksuar se, [...] ish-drejtori i Urbanizmit, Arbër Sadiki që e ka nënshkruar vendimin e parë për ricaktim të kushteve ndërtimore [Qendra Tregtare "C-P"], ishte aksionar në kompaninë "G+A Architects", e cila e ka bërë projektin fillestar të kësaj Qendre Tregtare. Në vitin 2019, kur ishte marrë leja e parë për kushtet e ndërtimit për këtë Qendër Tregtare, Arbër Sadiki ishte aksionar në kompaninë "G+A Architects", e cila e kishte hartuar projektin [...] Në lejen e lëshuar nga Komuna e Prishtinës në vitin 2020 thuhet se 'faza e arkitekturës' është punuar nga Arbër Sadiki. Gati katër vite më pas, Sadiki ishte në pozitën e drejtorit të Urbanizmit në Komunën e Prishtinës kur ishte bërë kërkesa për "Ricaktim" të kushteve ndërtimore për C-P. [...] në kohën e ricaktimit të kushteve ndërtimore dhe lejes ndërtimore, hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor e ka realizuar [një kompani tjetër].

Rrjedhimisht në shkrimin si më lart, përveç pretendimeve për konflikt të interesit, janë ngritur edhe dyshime lidhur me (pa)rregullsinë dhe (kundër)ligjshmërinë e procesit të nxjerrjes së vendimeve nga Komuna e Prishtinës në lidhje me qendrën tregtare "C-P".

Agjencia konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar procedurën e hetimit administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar vetëm pretendimet për konflikt të interesit sipas dispozitave të LPKI-së, përkatësisht faktin nëse z. Arbër Sadiki ka qenë i përfshirë në vendimmarrjet e Komunës së Prishtinës për këtë qendër tregtare dhe nëse kjo vendimmarrje paraqet situatë të konflikt të interesit sipas dispozitave të LPKI-së.

Agjencia, me shkresën zyrtare DPKI-2/25, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Arbër Sadiki lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, është organizuar dhe mbajtur një takim me të në Agjenci, me ç'rast i njëjti është njoftuar me pretendimet për konflikt të interesit dhe faktet që posedon Agjencia lidhur me këtë rast.

Zyrtari i lartë publik z. Arbër Sadiki, në takimin e mbajtur, ka dhënë sqarimet e tij lidhur me pretendimet e ngritura për konflikt të interesit, si dhe ka dorëzuar në Agjenci disa vendime të Komunës së Prishtinës, në lidhje me projektin e qendres tregtare "C-P".

Më pas, Agjencia ka kërkuar nga z. Arbër Sadiki, informata dhe dokumentacion shtesë, lidhur me bazën sipas të cilës në vitin 2019, kompania "G+A Architects" SH.P.K., ka hartuar dokumentacionin ndërtimor - projektin kryesor/ideor për investitorin, në rastin e qendres tregtare "C-P", përfshirë kontratën/marrëveshjen apo çfarëdo dokumenti që "G+A Architects" SH.P.K. ka pasur me investitorin e qendres tregtare në fjalë, në bazë të të cilit është hartuar dokumentacioni si më lartë. Z. Arbër Sadiki, duke u përgjigjur në kërkesën e Agjencisë ka dërguar dokumentacionin e kërkuar.

Tutje, me qëllim të sqarimit të raportit të z. Arbër Sadiki me subjektin "G+A Architects" SH.P.K., Agjencia ka kërkuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) informata në lidhje me biznesin "G+A Architects" SH.P.K., të cilat janë përcjellë nga ARBK-ja sipas kërkesës.

Përveç kësaj, me qëllim të sqarimit të situatës, gjithnjë në kontest të zbatimit të dispozitave të LPKI-së dhe konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, e në bazë të kompetencave ligjore që ka

Agjencia, me shkresën zyrtare DPKI-1/25, ka kërkuar nga Komuna e Prishtinës informata dhe dokumentacion, në lidhje me aplikimet/kërkesat e investitorit dhe vendimet e Komunës së Prishtinës, për rastin e qendrës tregtare “C-P”. Komuna e Prishtinës me shkresë zyrtare ka dërguar në Agjenci informatat dhe dokumentacionin e kërkuar (DPKI-54/25), përfshirë edhe informatat dhe dokumentacionin plotësues të dërguar më pas nga zyra ligjor e kësaj komune.

Gjithashtu, Agjencia ka kërkuar edhe nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) informata dhe dokumentacion në lidhje me vendimet e kësaj ministrie (si organ i shkallës së dytë), përkitazi me ankesat ndaj vendimeve të Komunës së Prishtinës për qendrën tregtare “C-P”. MMPHI, duke vepruar sipas kërkesës si më lartë, ka dërguar në Agjenci përgjigjen, informatat dhe dokumentacionin e kërkuar (DPKI-234/25).

Pas grumbullimit të informatave si më lartë, Agjencia pas ka administruar si prova (ato që lidhen me vërtetimin e fakteve - pretendimeve për konflikt të interesit), raportimin e raportuesit të rastit, shkrimin në portal online, sqarimet dhe dokumentacionin e dorëzuar nga z. Arbër Sadiki, përfshirë edhe dokumentet e dërguara më pas sipas kërkesës së Agjencisë, pastaj përgjigjen dhe dokumentacionin e dërguar nga institucionet ARBK, Komuna e Prishtinës dhe MMPHI, si dhe dokumentet e siguruar nga Agjencia sipas detyrës zyrtare, ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Referuar regjistrimit për deklarimin e pasurisë të datës 18.02.2022, të cilin z. Arbër Sadiki e ka bërë në Agjenci, dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës Nr. 14-112/02-13908/22, i datës 20.01.2022, zyrtari i lartë në fjalë është emëruar Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës.

Pozitën me emërtimin si më lartë, z. Arbër Sadiki e ka ushtruar deri më datë 08.02.2024, pasi që sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës Nr. 14-101/03-21496/24, z. Arbër Sadiki është emëruar Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mjedisit (bashkim i drejtorive) në Komunën e Prishtinës.

Me Vendimin 05 Nr. 350/02-244341/19, i datës 18.11.2019, të Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, janë caktuar kushtet ndërtimore sipas kërkesës 05 Nr. 350/02-244341/19, e datës 04.10.2019, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e kompleksit të ndërtesave afariste, përkatësisht qendrës tregtare “C-P”. Ky vendim është i nënshkruar nga zyrtari përgjegjës për punimin e lëndës (K. Sh.) dhe u.d. Udhëheqësja e Sektorit (M. B-P.).

Më pas, bazuar në vendimin si më lartë, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës ka nxjerrë Vendimin 05 Nr. 351/02-62433/20, i datës 18.09.2020, me të cilin është lejuar ndërtimi i kompleksit të ndërtesave afariste, përkatësisht qendrës tregtare “C-P”, sipas kërkesës 05 Nr. 350/02-244341/19, e datës 04.10.2019. Ky vendim është i nënshkruar nga zyrtari përgjegjës për punimin e lëndës (Z. R.), u.d. Udhëheqësja e Sektorit (M. B-P.) dhe Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit në atë kohë (A. O.).

Referuar pikës II. të dispozitivit të vendimit si më lartë, rezulton se hartimin e dokumentacionit ndërtimor - projektin kryesor/ideor për ndërtesën investive (qendrën tregtare “C-P”), e ka bërë “G+A Architects” SH.P.K., ndërsa pjesë e ekipit profesional projektues për fazën e arkitekturës

ka qenë z. Arbër Sadiki. Kjo është vërtetuar edhe nga projekti i bashkangjitur vendimit për leje të ndërtimit, i cili është i vulosur me vulën e subjektit "G+A Architects" SH.P.K. dhe i nënshkruar nga z. Arbër Sadiki.

Sipas historikut të biznesit "G+A Architects" SH.P.K., të cilin Agjencia e ka pranuar nga ARBK, rezulton se z. Arbër Sadiki, ka qenë njëri nga aksionarët dhe drejtor i biznesit në fjalë, nga data 14.06.2018 deri më datë 23.02.2022.

Rrjedhimisht, në kohën e hartimit të dokumentacionit ndërtimor - projektit kryesor/ideor për qendrën tregtare "C-P", z. Arbër Sadiki ka qenë aksionar dhe drejtor i subjektit "G+A Architects" SH.P.K., i cili ka hartuar projektin, njëherit i përfshirë si arkitekt në këtë projekt.

Nga marrëveshja për shërbime e datës 26.03.2020, të cilën Agjencia e ka pranuar nga z. Arbër Sadiki, rezulton se subjekti "G+A Architects" SH.P.K. dhe investitorët e qendres "C-P". kanë pasur një marrëveshje (kontratë) për hartimin e projektit të qendres në fjalë. Kjo marrëveshje, në emër të ofruesit të shërbimeve "G+A Architects" SH.P.K., është e vulosur me vulën e këtij biznesi dhe nënshkruar nga përfaqësuesi i tij, por që krahasuar me nënshkrimet e z. Arbër Sadiki nëpër dokumentet që posedon Agjencia, nuk rezulton se është nënshkrimi i tij.

Me Vendimin 05 Nr. 350/02 – 244341/19, i datës 28.07.2023, të Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, është miratuar kërkesa e investitorëve të qendrës tregtare "C-P", 05 Nr. 350/02-102847/23, e datës 23.05.2023, për ri – caktimin e kushteve ndërtimore, përkatësisht për ndryshim - plotësim dhe zgjerim të kushteve ndërtimore të miratuara me Vendimin 05 Nr. 350/02-244341/19, i datës 18.11.2019, të kësaj drejtorie. Ky vendim është i nënshkruar nga zyrtari përgjegjës për punimin e lëndës (E. H.), Udhëheqësja e Sektorit (N. K.) dhe z. Arbër Sadiki, cilësi të Drejtori të Drejtorisë së Urbanizmit.

Sipas vendimit të sipërpërmendur, projektin për ndryshim - plotësim dhe zgjerim të kushteve ndërtimore, nuk e ka bërë subjekti "G+A Architects" SH.P.K. dhe as z. Arbër Sadiki në cilësi të arkitektit, por një subjekt tjetër.

Referuar përgjigjes së MMPHI dhe vendimeve të dërguara nga kjo ministri, rezulton se kundër Vendimit 05 Nr. 350/02 – 244341/19, i datës 28.07.2023, të Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, një grup i asambleistëve të kësaj komune ka parashtruar ankesë, të cilin MMPHI me Vendimin Nr. A-168/23, i datës 22.11.2023 (vendim përfundimtar në procedurën administrative), e ka aprovuar si të bazuar, duke anuluar Vendimin 05 Nr. 350/02 – 244341/19, i datës 28.07.2023, të Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës (vendimi i nënshkruar nga z. Arbër Sadiki), si dhe ka obliguar këtë drejtori të veprojë konform Ligjit për ndërtim dhe Planit Zhvillimor Urban.

Referuar dokumentacionit që Agjencia ka në dispozicion (përgjigja e MMPHI dhe përgjigja e dokumentacioni plotësues i zyrës ligjore të Komunës së Prishtinës), kundër vendimit si më lartë të MMPHI, Komuna e Prishtinës ka inicuar procedurë të konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente, por që më pas ka hequr dorë nga kjo padi sipas parashtresës nr. 2673, e datës 23.08.2024, për heqje dorë nga padia e datës 10.01.2024, lënda KA.nr.22/24, pasi që Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë të rishqyrtimit të kërkesës së investitorëve 05 Nr. 350/02-

102847/23, e datës 23.05.2023, ka nxjerrë vendim të ri në zbatim të Vendimit Nr. A-168/23, i datës 22.11.2023, të MMPIH.

Konkretisht, Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Prishtinës pas vendimit të MMPIH Nr. A-168/23, i datës 22.11.2023, në procedurë të rishqyrtimit të kërkesës 05 Nr. 350/02-102847/23, e datës 23.05.2023, të investitorëve të qendrës tregtare "C-P", me Vendimin 05 Nr. 350/02 – 244341/19, i datës 22.01.2024, ka bërë ri - caktimin e kushteve ndërtimore. Ky vendim është i nënshkruar nga zyrtari përgjegjës për punimin e lëndës (E. H.), Udhëheqësja e Sektorit (N. K.), ndërsa i njëjti nuk është nënshkruar nga z. Arbër Sadiki, i cili në atë kohë ka qenë Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit.

Duke qenë se ky vendim është nxjerrë në procedurë të rishqyrtimit të kërkesës së investitorëve 05 Nr. 350/02-102847/23, e datës 23.05.2023, rrjedhimisht, vlenë ajo që u tha më lartë se projektin për ndryshim - plotësim dhe zgjerim të kushteve ndërtimore, të cilin e ka marrë për bazë vendimi, nuk e ka bërë subjekti "G+A Architects" SH.P.K. e rrjedhimisht as z. Arbër Sadiki, por një subjekt krejt tjetër.

Edhe kundër Vendimit 05 Nr. 350/02 – 244341/19, i datës 22.01.2024, grupi i asambleistëve të Lëvizjes Vetvendosje të Komunës së Prishtinës ka parashtruar ankesë. MMPIH duke vendosur sipas kësaj ankese, me Vendimin Nr. A-44/24, i datës 10.07.2024 (vendim përfundimtar në procedurën administrative), ka shpallë të paligjshëm Vendimin 05 Nr. 350/02 – 244341/19, i datës 22.01.2024, të Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës.

Kundër vendimit si më lartë, Komuna e Prishtinës ka parashtruar padi për inicim të procedurës së konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente, dhe në bazë të përgjigjeve të MMPIH dhe Komunës së Prishtinës, nuk ka informata nëse gjykata ka shqyrtuar padinë.

Më pas, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës me Vendimin 05 Nr. 351/02 - 62433/20, i datës 24.04.2024, ka miratuar kërkesën e investitorëve të qendrës tregtare "C-P", të datës 04.08.2024, me ç'rast ka bërë ndryshim - plotësim dhe zgjerim të dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor i miratuar me vendimin e lejes ndërtimore 05 Nr. 351/02-62433/20, i datës 18.09.2020, dhe ndryshuar me vendimin 05 Nr. 351/02-62433/20, i datës 29.09.2021. Ky vendim është i nënshkruar nga zyrtari përgjegjës për punimin e lëndës (E. H.), Udhëheqësja e Sektorit (N. K.), ndërsa i njëjti nuk është nënshkruar nga z. Arbër Sadiki.

Edhe sipas vendimit si më lartë rezulton se, hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndryshim - plotësim dhe zgjerim, nuk e ka bërë subjekti "G+A Architects" SH.P.K. dhe as z. Arbër Sadiki, por një subjekt krejt tjetër.

Lidhur me obligimin për (mos)nënshkrim të vendimeve nga Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Komuna e Prishtinës në përgjigjen zyrtare ka sqaruar se, citojmë pjesë relevante nga përgjigja:

"[...] Sipas praktikës së mëhershme, kanë qenë të vendosur edhe emrat e drejtorëve në Vendimet e drejtorisë së urbanizmit, edhe pse vendimarrja në bazë të Ligjit është e zyrtarit përgjegjës, [...] pas analizës së këtyre çështjeve dhe bazës së tyre ligjore, ka kohë që emri i drejtorit nuk figuron në këto vendime, pasi që drejtorët e drejtorive janë emërime politike, të cilët kanë përgjegjësi hartimin e politikave strategjike të drejtorisë dhe jo shqyrtimin e lëndëve.

Për të shmangur çdo paqartësi ligjore lidhur me këtë çështje, drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, me dt. 15.08.2023, i është drejtuar zyrës ligjore të Kryeqytetit për interpretim ligjor në lidhje me përgjegjësinë e vendim marrjes së akteve administrative që i lëshon drejtoria, respektivisht çështjes së aktet administrative, a duhet të nënshkruhen nga drejtori, apo nga zyrtaret përgjegjës që zhvillojnë procedurën administrative. [...] Zyra Ligjore e Kryeqytetit, ka kthyer përgjigje përmes email-it zyrtar [e cila përgjigje është bashkangjitur], ku ka potencuar se në bazë të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 27, paragrafi 1 të ligjit, është përcaktuar se: "1. Përveçse kur parashihet ndryshe me ligj, zyrtari përgjegjës zhvillon procedurën administrative, vendos për çështjen, e nënshkruan vendimin si dhe siguron njoftimin e palës". [...] meqenëse në Ligjin nr. 04/L-110 për ndërtim, si Ligj Special, nuk është rregulluar kjo çështje, por është përcaktuar se vendimin e merr organi kompetent në rastin konkret Drejtoria e Urbanizmit, kurse vendimmarrja i takon zyrtarit përgjegjës, apo shefit të sektorit, të cilët përfaqësojnë organin kompetent si zyrtar profesional dhe kanë kualifikimet adekuate për shqyrtimin e lëndëve dhe nxjerrjen e akteve administrative në emër të organit kompetent gjegjësisht Drejtorisë së Urbanizmit, [...] andaj dhe duhet të merret për bazë rregullimi i përcaktuar sipas Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative [...]."

Referuar përgjigjes zyrtare të MMPHI-së, kundër Vendimit 05 Nr. 351/02 - 62433/20, i datës 24.04.2024, ka parashtruar ankesë një grup i asambleistëve të Komunës së Prishtinës, por ende MMPHI nuk ka vendosë për këtë ankesë.

Nga arsyetimi i vendimit si më lartë, rezulton se leja ndërtimore (për ndryshim-plotësim dhe zgjerim) e dhënë sipas vendimit të datës 24.04.2024, është nxjerrë në zbatim të Vendimit 05 Nr. 350/02 – 244341/19, i datës 22.01.2024, për ri - caktimin e kushteve ndërtimore, të cilin nuk e ka nënshkruar z. Arbër Sadiki, e jo sipas Vendimit 05 Nr. 350/02 – 244341/19, i datës 28.07.2023, të cilin e ka nënshkruar z. Arbër Sadiki.

Lidhur me këtë situatë, Agjencia i është referuar Ligjin Nr. 04/L – 110 për ndërtim, konkretisht nenit 17 [Procedura e përgjithshme për lëshimin e lejes ndërtimore], me të cilin është përcaktuar se:

"1. Lëshimi i lejes ndërtimore kalon nëpër dy (2) faza: 1.1. Faza I: organi kompetent parasheh kushtet ndërtimore [...]; dhe 1.2. Faza II: leja ndërtimore lëshohet nga organi kompetent [...]", lidhur me paragrafin 1 dhe 2 të nenit 21 [Procedura për lëshimin e lejes ndërtimore] të këtij ligji, me të cilin është përcaktuar se: "1. Leja ndërtimore lëshohet nëse dokumentacioni ndërtimor përgatitet në pajtueshmëri me kushtet ndërtimore [...]. 2. Nëse organi kompetent vlerëson se dokumentacioni ndërtimor nuk është përgatitur në përputhje me kushtet ndërtimore dhe [...] nuk do të lëshojë lejen ndërtimore [...]."

Rrjedhimisht, në kuptim të dispozitave si më lartë, lëshimit të lejes ndërtimore i paraprinë lëshimi i lejes për kushtet ndërtimore. Në rastin konkret, lëshimit të lejes ndërtimore sipas Vendimit 05 Nr. 351/02 - 62433/20 i datës 24.04.2024, nuk i ka paraprirë Vendimi 05 Nr. 350/02 – 244341/19, i datës 28.07.2023, të cilin e ka nënshkruar z. Arbër Sadiki, sepse siç është konstatuar më lartë, ky vendim është anuluar nga MMPHI dhe Komuna e Prishtinës më pas, në procedurë të rishqyrtimit të kërkesës së investitorëve sikurse është obliguar nga kjo ministri, ka nxjerrë Vendimin 05 Nr. 350/02 – 244341/19, i datës 22.01.2024, për ri - caktimin e

kushteve ndërtimore, të cilin nuk e ka nënshkruar z. Arbër Sadiki, e i cili vendim i ka paraprirë lëshimit të lejes ndërtimore (ndryshim - plotësim dhe zgjerim) me Vendimin 05 Nr. 351/02 - 62433/20 i datës 24.04.2024.

Për më tepër, për ta sqaruar efektin juridik që (nuk)ka prodhuar Vendimi 05 Nr. 350/02 – 244341/19, i datës 28.07.2023 (i nënshkruar nga z. Arbër Sadiki), i anuluar nga MMPHI, Agjencia i është referuar Ligjit Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative (LPPA).

Fillimisht është sqaruar efekti i ankesës së parashtruar ndaj vendimit si në paragrafin më sipër dhe lloji i vendimeve që mund t'i nxjerrë organi epror (i shkallës së dytë) në lidhje me ankesën. Lidhur me këtë Agjencia i është referuar paragrafit 1 të nenit 130 [Efektet e parashtrimit të ankesës] të LPPA, me të cilin është përcaktuar se:

“Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidhë ankesën.” Në rastin konkret, vet fakti i parashtrimit të ankesës ndaj Vendimit 05 Nr. 350/02 – 244341/19, i datës 28.07.2023, nga grupi i asambleistëve të Lëvizjes Vetvendosje, ka pezulluar efektin - prodhimin e pasojave juridike të vendimit në fjalë.

Ndërsa me paragrafin 4, të nenit 132 [Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi epror] të LPPA, është përcaktuar se: *“Nëse organi epror vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar, ai duhet të vendosë përfundimisht me një akt të ri që të anuloj apo ndryshoj, plotësisht apo pjesërisht, aktin e ankimuar, gjegjësisht do të nxjerrë aktin e kërkuar nga pala.”*

Në rastin konkret, MMPHI me Vendimin Nr. A-168/23, i datës 22.11.2023, sipas ankesës ka anuluar Vendimin 05 Nr. 350/02 – 244341/19, i datës 28.07.2023.

Tutje, me nenin 53 [Procedura dhe efektet e anulimit dhe shfuqizimit] të LPPA, është përcaktuar se: *“1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj. 2. Anulimi i një akti administrativ ka pasoja në të kaluarën (retroaktive), ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm në të ardhmen [...]. 3. Anulimi apo shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë.”*

Në rastin konkret, Vendimi 05 Nr. 350/02 – 244341/19, i datës 28.07.2023, është anuluar nga MMPHI si organ epror (i shkallës së dytë), që nënkupton se i njëjti nuk ka prodhuar fare efekt - pasoja juridike, është jo ekzistent.

Si përfundim i konstatimeve si më lartë, në gjithë këtë proces z. Arbër Sadiki, në cilësi të Drejtorit të Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, ka nënshkruar vetëm Vendimin 05 Nr. 350/02 – 244341/19, i datës 28.07.2023, dhe asnjë vendim tjetër. Ndërsa, vendimi i nënshkruar nga ai, nuk ka prodhuar asnjë efekt - pasoja juridike (është jo ekzistent), për faktin se ky vendim është anuluar nga MMPHI me Vendimin Nr. A-168/23, i datës 22.11.2023 (përfundimtar në procedurën administrative), dhe se më pas, Komuna e Prishtinës në procedurë të rishqyrtimit të kërkesës së investitorëve pas anulimit të vendimit nga MMPHI, ka nxjerrë

një vendim të ri, përkatësisht Vendimin 05 Nr. 350/02 – 244341/19, i datës 22.01.2024, për ri - caktimin e kushteve ndërtimore, të cilin vendim nuk e ka nënshkruar z. Arbër Sadiki.

Andaj, në vështrim të pretendimeve dhe gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, Agjencia vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi, se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 dhe nenit 17 lidhur me nenin 3, si dhe nenit 9, paragrafi 8, nënparagrafi 1.8 dhe nenit 19, paragrafin 2, nënparagrafin 2.2, të LPKI-së.

Së këndejmi, konflikti i interesit është i lidhur ngusht me *vendimmarrjen* e zyrtarit në një çështje të caktuar, në të cilën zyrtari ka apo mund të ketë *interes* privat për vete apo për *personat e afërm* me të.

Kështu, me nenin 6 të LPKI-së është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: *“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka **interes privat**, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”*, ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të LPKI-së është përcaktuar se: *“Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së **interesit të tij privat** ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.”*

... lidhur me nenin 3 [Përkufizimet] paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LPKI-së, me të cilin është përkufizuar se: *“**interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste**”*, dhe nënparagrafi 1.6, me të cilin është përkufizuar se: *“Person i afërm me zyrtarin është – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. Për qëllime të këtij ligji, personi juridik konsiderohet si person i afërm, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Si dhe nënparagrafi 1.12, me të cilin është e definuar nocioni i vendimmarrje si: *“çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.”**

Me neni 9 [Veprimet e ndaluara për zyrtarin], paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të LPKI-së, është përcaktuar se: *“1. Gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtarit i ndalohen këto veprime: [...] 1.8. të ndërmarrë veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten **interesit personal të tij** apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik, të bashkaksionarëve apo personave në lidhje të mëhershme afariste në pesë (5) vitet e fundit.”*

Përveç kësaj, me dispozitat e nenit 19 [Masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave], paragrafi 2 të LPKI-së, janë përcaktuar detyrimet e udhëheqësit dhe institucionit

udhëheqës për të ndërmarrë masa për zgjidhjen e situatave të mundshme të konfliktit të interesit. Konkretisht dispozita në fjalë përcakton se: “2. Çdo udhëheqës i zyrtarit ose institucion udhëheqës merr masat e nevojshme, të përshkallëzuara dhe proporcionale për të shmangur paraprakisht dhe në çdo rast konfliktin real ose të mundshëm të interesave për shkak të zgjedhjes, emërimit apo caktimit të detyrave ose përgjegjësi të caktuara të zyrtarit. Këto masa përfshijnë por nuk kufizohen: [...] 2.5. revokimin ose anulimin e një akti të marrë në kushtet e konfliktit të interesave.”

Në rastin konkret, në kuptim dhe zbatim të dispozitave si më lartë të LPKI-së, është fakt se z. Arbër Sadiki, në cilësi të Drejtorit të Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës ka nënshkruar Vendimin Nr. 350/02 – 244341/19, i datës 28.07.2023, me të cilin është miratuar kërkesa e investitorëve, me të cilët investitorë në vitin 2020, biznesi “G+A Architects” SH.P.K. në të cilën z. Arbër Sadiki ka pasur aksione, ka pasur marrëveshje për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor ideor, e ku z. Arbër Sadiki në cilësi të arkitektit ka qenë i përfshirë në hartimin e këtij projekti. Por, kjo situatë nuk paraqet situatë të konfliktit të interesit, përkatësisht nuk bie ndesh me dispozitat e LPKI.

Kjo për faktin se, nga Vendimi Nr. 350/02 – 244341/19, i datës 28.07.2023, të cilin e ka nënshkruar z. Arbër Sadiki, nuk ka pasur interes privat apo çfarëdo përfitimi as zyrtari në fjalë, e as investitorët e qendrës tregtare “C-P”, sepse siç u konstatua më lartë, vendimi në fjalë nuk ka prodhuar kurrfarë efekti - pasoja juridike, për shkak se i njëjti është anuluar nga MMPHI me vendim përfundimtar në procedurën administrative, ndërsa vendimi i cili është nxjerrë nga Komuna e Prishtinës, pas anulimit të këtij vendimi, në procedurë të rishqyrtimit të kërkesës së investitorëve, nuk është nënshkruar nga z. Arbër Sadiki.

Pjesëmarrja e zyrtarit në vendimmarrje dhe ekzistimi i interesit privat (çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste) të zyrtarit në atë vendimmarrje, janë kushte kumulative të cilat duhet të plotësohen në çdo rast për t’u konsideruar se ka konflikt të interesit në vendimmarrje, sipas dispozitave të nenit 6 dhe nenit 17, lidhur me nenin 3 të LPKI-së. Në këtë rast, siç është konstatuar më lartë, z. Arbër Sadiki ka nënshkruar Vendimin Nr. 350/02 – 244341/19, i datës 28.07.2023, por këtu nuk është plotësuar kushti tjetër kumulativ, që është *interesi i privat*, përkatësisht përfitimi i çfarëdo përparësie për vete apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste. Andaj, situata e parashtruar nuk bie ndesh me nenin 6, dhe 17, lidhur me nenin 3 të LPKI-së.

Gjithashtu, për shkak se i njëjti nuk ka prodhuar kurrfarë efekti - pasoja juridike, Vendimi Nr. 350/02 – 244341/19, i datës 28.07.2023, nuk mund të cilësohet as veprim i zyrtarit, i cili do t’i ishte përshtatur interesit të personave në lidhje të mëhershme afariste në pesë (5) vitet e fundit, në kuptim të nenit 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8 të LPKI-së.

Shto kësaj edhe faktin se, me veprimet e ndërmarra nga MMPHI për anulimin e Vendimit Nr. 350/02 – 244341/19, i datës 28.07.2023, janë anuluar edhe *pasojat eventuale* që lidhen me dyshimet për konflikt të mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik, të cilat pasoja kanë *mundur* të shkaktohen nëse vendimi në fjalë nuk do të ishte anuluar. Pra, në këtë rast konsiderohet se MMPHI, si organ epror i Drejtorisë së Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në

çështjen e dhënies së lejes ndërtimore, ka ndërmarrë masat konform nenit 19, paragrafi 2, nënparagrafi 2.5, të LPKI-së.

Dispozitat e LPKI-së nuk mëtojnë që të kufizojnë apo pengojnë ushtrimin e funksioneve publike, përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësiave ligjore dhe kushtetuese në institucione publike, por përkundrazi, njëri ndër qëllimet e rëndësishme të këtij ligji është funksionimi i institucioneve publike përmes parandalimit të shfrytëzimit të funksionit publik për interesa private, përkatësisht parandalimit të situatave të konfliktit të interesit, duke mbrojtur kështu interesin publik, ruajtur kredibilitetin dhe imazhin e institucioneve publike.

Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *“Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”*

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Yll Buleshkaj
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

Vendimi iu dërgohet:

- z. Arbër Sadiki;
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)